ODA EKONOMIKE - KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS OF COMMERCE
NO: 301
14.09.2026
PRISHTINË

LUXEMBOURG AID & DEVELOPMENT

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS | KOSOVA CHAMBER OF COMMERCE

LUXDEV Luxembourg Development Agency

Në bazë të nenit 19 të Ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës Nr. 2004/7, nenit 27 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës, Kryetari i OEK shpallë:

FTESË PUBLIKE PËR SHËRBIME TË VERIFIKIMIT TË SHPENZIMEVE

Në kuadër të projektit: "Nxitja e inovacionit dhe qëndrueshmërisë për sistemin Dual VET në Kosovë"

Marrëveshja e Delegimit KSV/021

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) është organizata kryesore e anëtarësimit të bizneseve që përfaqëson interesat e sektorit privat në Republikën e Kosovës. Përmes Qendrës për Arsimin Dual (QAD) janë duke u implementuar aktivitetet e projektit "Fostering innovation and sustainability for the dual VET system in Kosovo" në kuadër të Marrëveshjes së Delegimit KSV/021 • 25 3685, të financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut përmes LuxDev (Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor).

Me qëllim të sigurimit të transparencës, llogaridhënies financiare dhe përputhshmërisë së plotë me standardet ndërkombëtare dhe rregullat e donatorit, OEK shpall këtë ftesë publike për angazhimin e një shoqërie të kualifikuar auditimi ligjor apo auditori të kualifikuar për verifikimin e pavarur të shpenzimeve të projektit.

Objektivi i angazhimit

Qëllimi kryesor i kësaj ftese publike është kontraktimi i një shoqërie të licencuar auditimi ligjor (apo konsulenti të kualifikuar) për kryerjen e shërbimeve të verifikimit të shpenzimeve dhe auditimit të jashtëm financiar të projektit. Angazhimi konsiston në zbatimin e procedurave të rëna dakord (Agreed-Upon Procedures) sipas standardit ndërkombëtar ISRS 4400 (International Standard on Related Services) dhe kërkesave të përcaktuara në Shtojcën VII (Appendix VII) të Marrëveshjes së Delegimit për Fonde dhe Zbatim (DAFI).

Shoqëria e auditimit/Auditori i pavarur do të kryejë procedura faktike të verifikimit për të vërtetuar nëse shpenzimet e deklaruara nga OEK janë reale, të sakta aritmetikisht, të pranueshme sipas marrëveshjes DAFI, të mbështetura plotësisht me dokumentacion

burimor origjinal dhe prova bankare, si dhe nëse janë zbatuar rregullat e prokurimit dhe kontrolleve të brendshme financiare. Rezultati kryesor do të jetë Raporti i Gjetjeve Faktike (Factual Findings Report) i hartuar në gjuhën angleze.

Fushëveprimi i shërbimeve kryesore

Shoqëria e auditimit/Auditori do të kryejë verifikimin e zbatimit financiar të projektit për periudhën **1 nëntor 2025 – 30 shtator 2026**, duke përfshirë:

- Buxhetin e miratuar të projektit dhe ndryshimet/rialokimet përkatëse;
- Të ardhurat, shpenzimet dhe dokumentacionin mbështetës të projektit;
- Përputhshmërinë e shpenzimeve me kërkesat e pranueshmërisë, buxhetin e miratuar dhe Marrëveshjen e Delegimit;
- Saktësinë e raportit financiar përfundimtar dhe rakordimin me regjistrat kontabël dhe bankarë;
- Përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme dhe pajtueshmërinë me procedurat e prokurimit dhe kontraktimit;
- Verifikimin e realizimit faktik, regjistrimit, dokumentimit, atribuimit në projekt dhe mungesës së financimit të dyfishtë të kostove;
- Verifikimin e kostove administrative dhe kategorive të tjera të shpenzimeve të raportuara.

Rezultatet e pritshme (Dorëzimet)

Shërbimi i auditimit duhet të rezultojë në dorëzimin e produkteve të mëposhtme në gjuhën angleze:

- Draft-Raporti i Gjetjeve Faktike, me procedurat e kryera, fushëveprimin e verifikimit, gjetjet dhe shpenzimet e papranueshme, të pambështetura ose të diskutueshme, sipas rastit;
- Raporti Përfundimtar i Gjetjeve Faktike, duke përfshirë komentet e KCC-së, procedurat e dakordësuara dhe gjetjet përfundimtare;
- Vërejtjet mbi dobësitë e kontrollit të brendshëm, pajtueshmërinë, prokurimin dhe dokumentacionin, sipas rastit;
- Pasqyra e shpenzimeve të papranueshme, të pambështetura ose të diskutueshme,

Kohëzgjatja e angazhimit

Angazhimi pritet të zbatohet brenda një periudhe mes **15 – 22 ditë** pune nga data e nënshkrimit të kontratës. Draft raporti pritet të dorëzohet brenda dy javëve nga fillimi i punës në terren, ndërsa raporti përfundimtar i kompletuar duhet të dorëzohet jo më vonë se data **31 tetor 2026**.

Kriteret e kualifikimit

Kandidatët / shoqëritë e interesuara të auditimit duhet të dëshmojnë përmbushjen e kritereve të mëposhtme:

- Të jetë shoqëri auditimi e regjistruar ligjërisht në Kosovë (ARBK) dhe të ketë licencat dhe certifikimet përkatëse;
- Përvojë profesionale në ofrimin e shërbimeve të auditimit të jashtëm financiar dhe verifikimit të shpenzimeve;
- Përvojë të dëshmuar në auditimin e projekteve në auditimin financiar të projekteve të financuara nga donatorë ose nga burime ndërkombëtare;
- Aftësitë gjuhësore të shkrimit dhe hartimit të raporteve në gjuhën angleze;
- Pavarësia ligjore nga OEK dhe LuxDev, pa asnjë konflikt interesi aktual apo të perceptuar.

Dokumentet për aplikim

Aplikuesit e interesuar duhet të dorëzojnë dosjen e plotë të aplikimit, e cila duhet të përmbajë dokumentacionin vijues:

- Propozim teknik;
- Propozim financiar;
- Profilin e kompanisë së bashku me dëshminë e regjistrimit ligjor
- CV-të dhe kualifikimet profesionale të auditorit/ auditorëve të propozuar
- Dëshmi të përvojës relevante dhe referenca;
- Deklaratën e pavarësisë, me të cilën konfirmohet mungesa e çdo konflikti interesi dhe ruajtja e konfidencialitetit gjatë dhe pas përfundimit të angazhimit.

Buxheti dhe kushtet financiare

Buxheti i përgjithshëm i parashikuar për këtë detyrë auditimi është 3,500.00 EUR (PA TVSH). Ky çmim përfshin të gjitha tarifat e auditimit, shpenzimet e komunikimit, transportit, raportimit dhe të gjitha kostot e nevojshme për zbatimin e plotë të detyrës.

Afati për Dorëzim

Aplikimet duhet të dorëzohen elektronikisht jo më vonë se ***23 shtator 2026*** në arsimidual@oek-kcc.org me subjektin: **"Aplikim – Shërbime të Verifikimit të Shpenzimeve KSV/021".**

Aplikimet e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në konsideratë.

Informata Shtesë

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen për vlerësim të mëtejmë.

Termat e Referencës (ToR) mund të ndahen sipas kërkesës, përmes kontaktit me: arsimidual@oek-kcc.org .

Lulzim Rafuna

Kryetar

Oda Ekonomike e Kosovës